

# TERAPI ELEKTRO-KONVULSIVE PËR PACIENTË TË MBAJTUR NË SPITAL

(Paragrafi 58A i Aktit të Shëndetit Mendor 1983)

## Ç'është kjo fletëpalosje?

Kjo fletëpalosje shpjegon rregullat e veçanta të Aktit të Shëndetit Mendor 1983 lidhur me përdorimin e terapisë elektro-konvulsive (ECT) për të mjekuar çrregullimin mendor. Këto rregulla i gjeni në paragrafin 58A të Aktit të Shëndetit Mendor.

## Ç'është terapia elektro-konvulsive?

ECT-ja është një mjekim që përdoret për një numër të vogël të çrregullimeve mendore, siç është depresioni, mania dhe katatonia. Gjatë ECT-se, një korent elektrik kalon nëpër tru për një kohë të shkurtër dhe shkakton konvulsion (krizë). ECT-ja bëhet me anestezion të përgjithshëm dhe pacientëve ju jepen hapa për relaksim të muskujve për t'ju shmangur dhimbjeve gjatë krizës. Zakonisht, ECT-ja bëhet në një seri prej gjashtë deri 12 sesione, nga një person i specializuar.

Nëse stafi i spitalit mendon se është mirë të bëni një ECT, ata do t'ju shpjegojnë se ç'është ajo dhe pse mendojnë se duhet ta bëni atë.

## A mund të refuzoj ECT-në?

Nëse jeni të aftë të vendosni për vetëveten, ju nuk keni nevojë të pranoni ECT-në, pa dëshirën tuaj. Ju do ta bëni ECT-në vetëm nëse jeni dakord, ose nëse është rast i domosdoshëm.

## Çfarë ndodhë nëse jam nën moshën 18 vjeç?

Nëse jeni nën moshën 18 vjeç dhe pranoni ta bëni ECT-ne, një mjek i cili nuk është nga spitali në të cilin jeni duke u mjekuar, do të vjen për t'ju vizituar.

Ky mjek i pavarur quhet SOAD (Mjek i caktuar për një mendim tjetër) dhe është i caktuar nga një Komision i pavarur i cili e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor.

Mjeku i pavarur do të bisedoj me ju dhe me stafin e spitalit që ju njeh juve. Juve mund t'ju bëhet ECT-ja vetëm nëse ju dhe mjeku i pavarur bini dakord për këtë, apo nëse është rast i domosdoshëm.

## Çfarë ndodhë nëse stafi i spitalit mendon se unë nuk jam në gjendje të vendos për vetëveten?

Spitali mendon se për shkak të çrregullimit tuaj mendor ju nuk jeni në gjendje të vendosni për vetëveten nëse duhet ta bëni ECT-në ose jo.

Kjo do të thotë se ata mendojnë se ju nuk e kuptoni se ç'është ECT-ja, për çfarë përdoret dhe cilat mund të jenë pasojat dhe dobitë.

Nëse ata mendojnë se ju nuk jeni në gjendje të vendosni për vetëveten, stafi i spitalit do të caktojë një mjek të pavarur (SOAD) për t'ju vizituar. Mjeku i pavarur do të bisedoj me ju dhe stafin e spitalit që ju njeh juve.

Nëse mjeku i pavarur bjen ne dakord se ju nuk jeni në gjendje të vendosni për vetëveten, atëherë ai mund t'i jep leje stafit të spitalit për t'ua bërë ECT-në. Përveç në rast urgjent, ECT-ja mund t'ju bëhet vetëm me miratimin e mjekut të pavarur.

Mirëpo, mjeku i pavarur nuk mund t'i jep leje stafit të spitalit për t'ju bërë ECT-në nëse ju e keni lidhur një marrëveshje paraprake me ligj për të refuzuar ECT-në sipas Aktit për Aftësi Mendore 2005 ose ndonjë person tjetër që ka të drejtë të marrë vendim në vendin tuaj në bazë të këtij Akti, dhe i cili thotë se ju nuk duhet ta bëni ECT-në. Ky mund të jetë një person i autorizuar me ligj, një zëvendës i juaji i caktuar nga Gjykata e Mbrojtjes, ose vetë Gjykata e Mbrojtjes. Stafi i spitalit mund t'ju jep më shumë informacion lidhur me Aktin për Aftësi Mendore të vitit 2005.

## Çfarë ndodhë në rast urgjent?

Në rast urgjent, juve mund t'ju bëhet ECT-ja edhe nëse ju ose mjeku i pavarur nuk keni rënë dakord për këtë.

Kjo mund të bëhet vetëm nëse keni nevojë për ECT aty për aty, për t'ju shpëtuar jetën, ose për të ndaluar keqësimin e shëndetit tuaj mendor.

## Kodi Praktik

Kodi Praktik është ai që i jep këshilla stafit të spitalit lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor dhe mjekimin e njerëzve nga çrregullimet mendore. Stafi duhet marrë parasysh se çfarë thot Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni, ju mund të kërkonit të shihni një kopje të Kodit.

## Si të ankohem?

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju jepen informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Nëse mendoni se procedura e ankimit nuk mund t'ju ndihmon, ju mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komisioni i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

### **Ndimë dhe informacion të mëtejshëm**

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkoni nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkoni një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.